



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1035/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Antonete Osmani kandidate për anëtare të kuvendit komunalë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qëndror Zgjedhor (KQZ), për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunalë në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Antonete Osmani kandidate për anetare të kuvendit komunalë në Prizren nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Antonete Osmani kandidate për anëtare të kuvendit komunalë nga subjekti politik AKR në Prishtinë në të cilën pretendon se Antonete Osmani ka qenë kandidate për asamble komunale nga AKR me numër 19 në listë, këtë ankesë e ka bërë e ka bërë për shkak që rezultati i publikuar nga KQZ-ja për asamblesitë nuk është i përafërt me rezultatin që e ka nga vëzhguesit nëpër pika të votimit dhe votuesit në teren numrin e votave që e ka arritur është mbi 140. Me këtë ankesë e ka bashkangjitur një listë të cilën i ka marrë rezultatet por që nuk janë përfundimtare për shkak se shume vendvotime janë pa u llogaritur si shkolla fillore Emin Duraku dhe Zenel Hajdini.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1035/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24(njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.